



"American Rescue Plan" ul koston e mbulimit shëndetësor për shumicën e njujorkezëve

"NY State of Health"
mund t'ju ndihmojë të kuptoni
ndihmën e re financiare,
të përditësoni shumën e kreditimit
të tatimit, si dhe të kërkonit e të
zgjidhni një plan shëndetësor.

Kontaktoni "NY State of Health":



Lidhuni përmes internetit në adresën:
nystateofhealth.ny.gov



Telefononi qendrën e shërbimit
ndaj klientit në numrin: 1-855-355-5777
(TTY:1-800-662-1220)



Merrni ndihmë falas nga një
asistent për regjistrim. Gjeni një
asistent në adresën:
info.nystateofhealth.ny.gov/findassistor

Për të mësuar më shumë rreth

"American Rescue Plan", ju lutemi vizitoni:

[https://info.nystateofhealth.ny.gov/
AmericanRescuePlan](https://info.nystateofhealth.ny.gov/AmericanRescuePlan)

Të kuptuarit e ndihmës së re financiare

- "American Rescue Plan" u nënshkrua si ligj më 11 mars 2021. Ai përfshin ndihmë financiare të re dhe me vlerë më të lartë për njujorkezët që regjistrohen në sigurimin shëndetësor nëpërmjet "NY State of Health".
- Kjo ndihmë financiare ofrohet për **të regjistruarit aktualë dhe të rinj**, duke përfshirë **individët me të ardhura më të larta që aplikojnë për herë të parë**.
- Kreditimet më të larta të tatimit ofrohen **tani** për njujorkezët me të ardhura më të ulëta ose mesatare. Për një individ, këto janë të ardhura deri në \$51,040 në vit. Për një familje me katër persona, këto janë të ardhura deri në \$104,800 në vit.
- Duke filluar nga **qershori**, kreditimet e reja të tatimit do t'ju ofrohen njujorkezëve, të ardhurat e të cilëve janë më të larta se këto shuma.
- Jini vigjilent ndaj njoftimeve dhe emaileve të "NY State of Health" që ju paralajmërojnë se kur ndodhin këto ndryshime dhe se çfarë duhet të bëni.

"NY State of Health" pajtohet me ligjet e zbatueshme federale dhe shtetërore për të drejtat civile dhe nuk diskriminon në bazë të racës, ngjyrës, kombësisë, besimit/fesë, gjinisë, moshës, gjendjes civile/familjare, aftësisë së kufizuar, kushteve të lidhura me shtatzëninë, gjendjes gjyqësore, dënimeve për vepra penale, identitetit gjinor, orientimit seksual, karakteristikave të predispozitave gjenetike, statusit ushtarak, statusit të viktimës së dhunës në familje dhe/ose hakmarrjes.

"American Rescue Plan" ul koston e mbulimit shëndetësor për shumicën e njujorkezëve

Çfarë duhet të bëni:

Nëse jeni regjistruar tashmë në një plan nëpërmjet "NY State of Health" dhe merrni ndihmë financiare:

- Ju tashmë kualifikoheni për më shumë ndihmë financiare.
- "NY State of Health" do të dërgojë letra në fillim të prillit me shumën e re dhe me vlerë më të lartë të kreditimit të tatimit. Ndiqni udhëzimet në letër për të përditësuar shumën e kreditimit të tatimit.
- Nëse nuk e përditësoni shumën e kreditimit të tatimit deri në qershor, "NY State of Health" do ta rrisë atë automatikisht për ju. Ju do të keni mundësinë të bëni ndryshime duke u identifikuar në llogarinë tuaj të "NY State of Health", duke kontaktuar asistentin tuaj të regjistrimit ose duke telefonuar në numrin 1-855-355-5777.

Nëse keni filluar një aplikim në "NY State of Health", por nuk jeni regjistruar në një plan shëndetësor:

- Nëse ju është thënë se kualifikoheshit për ndihmë financiare, tani ka gjasa të kualifikoheni për më shumë ndihmë. Identifikohuni përsëri në llogarinë tuaj të "NY State of Health" tani dhe kontrolloni për të parë nëse kualifikoheni për kreditime tatimi me vlerë më të lartë, më pas kërkoni dhe zgjidhni një plan.
- Nëse ju është thënë më parë se nuk kualifikoheshit për ndihmë financiare, tani ju mund të kualifikoheni. Identifikohuni përsëri në llogarinë tuaj të "NY State of Health" në qershor dhe kontrolloni për të parë nëse kualifikoheni për kreditime tatimi me vlerë më të lartë, më pas kërkoni dhe zgjidhni një plan.

Nëse jeni regjistruar tashmë në një plan të "NY State of Health" dhe nuk merrni ndihmë financiare:

- Tani mund të kualifikoheni për kreditim tatimi për primet.
- Këto kreditime tatimi do të ofrohen duke filluar nga qershori. "NY State of Health" do t'ju dërgojë një letër ku deklarohet shuma e re e kreditimit të tatimit. Udhëzimet se si të aplikoni për kreditimin e tatimit do të ofrohen në adresën <https://info.nystateofhealth.ny.gov/AmericanRescuePlan>

Nëse nuk jeni regjistruar në një plan nëpërmjet "NY State of Health" dhe nuk keni filluar asnjëherë një aplikim:

- Aplikoni tani në adresën nystateofhealth.ny.gov për të zbuluar se për çfarë kualifikoheni. Shumica e njujorkezëve kualifikohen për mbulim me kosto të ulët ose falas. Ndihma e përmirësuar financiare tani ofrohet nëse keni të ardhura më të ulëta ose mesatare (deri në \$51,040 në vit për një individ ose deri në \$104,800 në vit për një familje me katër persona).
- Nëse keni të ardhura më të larta (më shumë se \$51,040 në vit për një individ ose më shumë se \$104,800 në vit për një familje me katër persona), këto përfitime do të ofrohen nëpërmjet "NY State of Health" duke filluar nga qershori.